



# ARGUMENTUM

news opinion analysis



**SHBA: Është koha për  
themelimin e Asociacionit të  
komunave me shumicë serbe**

- Kina dhe Shqipëria në një marrëveshje monumentale për heqjen e vizave

- Suedi/Spanjë, sfida pa sensacione!

-2023 to be tougher for global economy IMF chief says

## Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten **Argumentum.al** në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

**Marjana DODA**  
Kryeredaktore

## Përmbajtja

### 03 REALPOLITIK

- Suedi/Spanjë, sfida pa sensacione! Kroacia në Schengen! Ec e ja, por dialog s'ka! “ Shkupi me 3 kunguj nën një sqetull!” Trampizmi “plagoset” në Uashington dhe në Brazil!

### 05 EDITORIAL

- Dialogu Prishtinë-Beograd/ SHBA: Është koha për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe

### 07 JO VETËM LAJMI

- IFIMES: A mund të përjetojë Kosova të njëjtin fat si Afganistani dhe Iraku?

### 10 OP/ED

- Kina dhe Shqipëria në një marrëveshje monumentale për heqjen e vizave

### 13 FOKUS

- Ish-zyrtari i arrestuar i FBI-së dhe lidhjet me Shqipërinë

### 16 RAJONI

- Kosovë/ Gjashtë kushtet e Albin Kurtit për krijimin e Asociacionit

### ENGLISH EDITION

### 20 REALPOLITIK

- Why Balkans in Davos? Like day and night!  
No news for our Resolution in Strasbourg! General “Winter” also failed!

### 25 ENGLISH TOP NEWS

- FP’s Chairman Meta says resignation of Edi Rama identified in the “McGonigal Affair” is a compulsory action

### 24 IN FOCUS

- Albania will host “Defender Europe 2023” military exercise  
- DP Deputy says Moscow is interested in a destabilized Balkans, while Serbia will recognize Kosovo when it is no longer dependent on Russia  
- Albanians and Chinese will travel without visas after agreement sealed by two governments

### 25 BALKAN OVERVIEW

- THE TIME FOR ESTABLISHING THE ASM IS NOW

### 25 GLOBAL NEWS

- 2023 to be tougher for global economy IMF chief says

# Suedi/Spanjë, sfida pa sensacione! Kroacia në Schengen! Eceja, pordialogs'ka! "Shkupime 3 kunguj nënjës qetull"! Trampizmi "plagoset" në Uashington dhe në Brazil!

REALPOLITIK "FLASH" NO. 61

2 - 16 JANAR 2023

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Shkurt dhe Shqip mbi 5 ngjarjet kryesore diplomatike me vetëm 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik

DR. JORGJI KOTE MJESHTER I MADH

**1. Suedi/Spanjë, sfida pa sensacione** pritet të jetë Presidencën e radhës e BE-së nga Suedia për gjysmën e parë dhe Spanja për gjysmën e dytë të vitit 2023. Themi kështu, sepse siç e përmendëm dhe në rubrikën e kaluar, Presidencën Çeke i realizoi të gjitha objektivat e saj, që shtrihen dhe në vitin 2023, përfshirë në veçanti Ballkanin Perëndimor. Kësisoj, Suedisë dhe më vonë Spanjës, nuk i mbetet ndonjë kulminacion tjetër apo arritje sensacionale; veç zbatimit dhe vijimit të punës së bërë deri tani nga gjithë BE-ja. Natyrisht agresioni rus në Ukrainë me pasojat e tij në të gjitha fushat do të vazhdojë të jetë në qendër të vëmendjes, krahas masave të tjera të gjithanshme politike dhe ekonomike për shmangien e pasojave të saj të mëdha. Po, highlight politik dhe diplomatik pritet të jetë Samiti II i Komunitetit Politik European (KPE) në Moldavi, ca më tepër për të bërë specifikimet e rastit lidhur me karakterin dhe objektivat e tij që mbeten ende të paqarta. Po ashtu, në Ballkanin Perëndimor "topi" tanimë do të luhet në portën e vendeve të tij. Shqipëria dhe Shkupi do të vijo-



jnë me fazën e skanimimit, në pritje të fillimit të vërtetë të negociatave, shpresojmë më 1 Janar 2024; Shkupi duhet të bëjë ndryshimet e nevojshme kushtetuese, me qëllim që të hiqet përfundimisht vetoja bullgare mbi të; me Kosovën do të pritet liberalizimi i vizave me formalitetet teknike të rastit, sepse vendimi politik është marrë, ndërsa Bosnia me procedurat përkatëse si vend kandidat për në BE me plot "detyra shtëpie".



Problem shqetësues mbetet Dialogu Prishtinë – Beograd, por ai i kapërcën kufijtë e Presidencës suedeze dhe spanjolle të BE-së.

Ja pse, ndryshe nga presidencat franceze dhe çeke, ato suedeze dhe spanjolle do të jenë rutinore dhe pa ndonjë aspekt të veçantë, natyrisht nëse nuk del ndonjë e papritur tjetër gjatë vitit.

**2. "3 Kunguj nënjës qetull" do të mundohet të mbajë Maqedonia e Veriut këtë vit;** ajo kryeson Nismën e Kartës së Adriatikut me 5 vende, tre prej të cilave janë në NATO, OSBE-në në një periudhë plot sfida dhe ndryshimin e Kushtetutës, me qëllim që të zbatohet Marrëveshja me Sofjen për t'i hapur rrugën çeljes së negociatave. Shumë e vështirë për lidhësin politik në Shkup,



nisur dhe nga gjendja e vështirë politike brenda vendit, përballë kërkesave të opozitës për zgjedhje të parakohshme. Më të vështira politikisht janë ndryshimet kushtetuese, sepse Karta e Adriatikut dhe OSBE-ja realisht janë më shumë formalitete diplomatike, pë ndonjë ndikim dhe interes publik.



Sepse OSBE-ja nuk është më ajo e 20 viteve më parë, pesha dhe roli i saj ka rënë ndjeshëm; krijimi i Komunitetit të ri Politik European mund të shihet dhe si një përpjekje për zëvendësimin e OSBE-së, tani që Rusia e “ka shkelur atë me të dyja këmbët”. Nuk thonë kot “ nuk mbahen dy kunguj nën një sjetull” e jo më tre, sa ka tani Maqedonia e Veriut!

**3. “Ec e ja, po dialog s’ka”!** Kështu mund të thuhet për odisenë e dialogut politik Prishtinë – Beograd; zhurmë, fjalë, ec e jake pa fund nga Brukseli, Uashingtoni, Berlini, Parisi drejt Beogradit dhe Prishtinës, me thirje për dialog por dialog s’ka! Ka vetëm monologë, veç njeri e veç tjetri. Me premtimin që në Mars të bëhet Marrëveshja përfundimtare. Çfarë wishful thinking ose “ dëshirore”! Kur jo vetëm gjuha që përdoret në Beograd, por sidomos gjendja në terrenin konkret flet vetëm për mosmarrëveshje, kërcënime, presione... Serbia vazhdon të

përdorë gjuhë të drunjtë, me asnjë shenjë distancimi nga e kaluara kriminale, asnjë afrim drejt njohjes së Kosovës por me zell drejt çnjohjeve! Vuçiq prapë deklaroi sapo takoi Këshilltarin e Lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit, Zotin Chollet se 500 herë do ta them se nuk e njohim Kosovën!



Dhe prapë SHBA dhe BE vazhdojnë ta mbajnë “ ta përkëdhelin dhe mbajnë me hatër” Beogradin, në emër të stabilitetit. Nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të themi “ Inshallah” për këtë dialog vendimtar!

**4. Kroacia në Schengen!** Më 1 Janar, Hapësira “Schengen” u zgjerua me hyrjen e Kroacisë në këtë zonë të madhe të lirisë. Sukses vërtet i madh historik politik, ekonomik dhe diplomatik i Kroacisë; ajo është bërë vërtet pikë reference dhe për integrimin tonë në BE. Në fakt, gjithmonë ajo ka qenë në pararojë. I mbaroi në një kohë rekord negociatat, brenda 4 viteve më 2008; u vonua vetëm për shkak të bllokadës slovene për pesë vit rresht. Sivjet bën 10 vjet që është antarësuar në BE. Sukses i bujshëm në këtë jubile! Ndërsa ne mburremi se BE-ja bëri një Samit në Tiranë, 13 vite mbas kërkesës sonë për antarësim, Kroacia ka bërë plot samite të tilla, shumë më herët, ama pa bujë e pa zhurmë!

**5. Trampizmi “ plagoset” në Uashington dhe në Brazil!** Vërtet, pas humbjes së Senatit dhe dështimit të “ valës së kuqe” në Kongres, ku fitoi fare ngushtë, Trump dhe republikanët pësuan një shuplakë tjetër politike javën e kaluar në Kongres. Vetëm mbas 15 raundeve me debate të ashpra u zgjodh Kryetari i ri i Kongresit, republikani Kevin McCarthy. Ama pas shumë lëshimeve ndaj kundërshtarëve të tij, çka i dobëson pozitat e tij dhe të republikanëve në vendimarrje. Dështimin tjetër jashtë vendit, Trumpi e pësoi në Brazil, ku “ vëllai” i vet politik Bolsonaro humbi përballë socialistit Lula. Ky i fundit erdhi për herë të tretë në pushtet, si për të vërtetuar thënien “ E treta, e vërteta”! Një javë pas inaugurimit të Lulas, mijra mbështetës të Bolsonaro mësynë dhe plaçkitën mjediset e parlamentit brazilian dhe institucioneve të tjera të larta. Një imitim i keq i 6 Janarit 2021 në Capitol Hill në Uashington, duke dhënë një imazh të keq për demokracinë braziliane, mu në zemër të saj! Me të drejtë u dënua nga të gjitha anët politike nga SHBA-të dhe Europa, por jo Trumpi. Brenda vendit, vetëm 20 për qind e mbështetin këtë rebelim ndaj një qeverie të ligjshme e të zgjedhur demokratikisht. Këto janë humbje të dhimbshme për Trump dhe trampizmin në përgjithësi, ogur jo i mirë për kandidaturën e tij për zgjedhjet e ardhshme presidenciale 2024. Gjithsesi, ka vend dhe kohë për të nxjerrë mësimet e duhura, sepse gjithçka do të varet nga ecuria e demokracive në SHBA dhe e Lulas në Brazil gjatë dy viteve të ardhshme.

## Dialogu Prishtinë-Beograd

# SHBA: Është koha për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe



***Nga: Derek Chollet, Këshilltar i Departamentit amerikan të Shtetit dhe Gabriel Escobar, I dërguari i posaçëm i SHBA-së për Ballkanin Perëndimor***

**D**erek Chollet, këshilltar i Departamentit amerikan të Shtetit dhe Gabriel Escobar, i dërguar i Posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, i bënë thirrje Kosovës të themelojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe, duke e siguruar atë se ky mekanizëm nuk e cenon Kushtetutën, sovranitetin, pavarësinë ose institucionet demokratike të saj.

Në një shkrim të përbashkët diplomatësh amerikanë thanë se Kosova dhe Serbia duhet të pranojnë propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre që do të ndërpriste ciklin e krizave dhe konfrontimit dhe të çonte përpara me vendosmëri integrimin e tyre evropian.

“Kjo është mundësi historike që

ne besojmë të dyja palët duhet ta shfrytëzojnë”, thuhet në shkrim në të cilin theksohet se ndër detyrat më thelbësore mbetet zbatimi i marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

### SHKRIMI I PLOTË:

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian i kanë vënë theks të ri integritetit të Ballkanit Perëndimor në familjen transatlantike. Në shkurt të vitit 2022, presidenti Biden dhe kancelari Scholz deklaruan se janë të përkushtuar “për të përmbyllur çështjen e integritetit të Ballkanit Perëndimor... që më në fund të realizohet një Evropë e tërë, e lirë dhe në paqe”.

Ndër qëllimet tona më të rëndësishme në Ballkanin Perëndimor është të ndihmojmë në krijimin e kushteve për marrëdhënie të shën-

deshme, paqësore dhe të qëndrueshme ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Gjatë javëve të shkuara, së bashku me Francën, Gjermaninë, Italinë dhe BE-në, kemi udhëtuar në Beograd dhe Prishtinë për t'i inkurajuar të dyja palët që ta pranojnë propozimin e BE-së për të dyja vendet që të normalizojnë marrëdhëniet, ta ndërpresin ciklin e krizave dhe konfrontimit dhe të çojnë përpara me vendosmëri integrimin e tyre evropian. Kjo është mundësi historike që ne besojmë të dyja palët duhet ta shfrytëzojnë.

Ndër detyrat më kritike mbetet zbatimi i marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Ka pasur shumë diskutime për Asociacionin dhe ka ardhur koha të tregohet qartë se çka është ky Asociacion e çka jo. Në përgjithësi, Asociacioni do të

ishite strukturë për komunat me popullatë me shumicë etnike serbe për t'i bashkërenditur çështjet dhe shërbimet si: arsimit, kujdesi shëndetësor, planifikimi urban dhe rural dhe zhvillimi ekonomik lokal – me fjalë të tjera, funksionet për të cilat të gjitha komunat në Kosovë janë përgjegjëse. Është mënyrë për përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve, krijimin e besimit ndërmjet serbëve etnikë dhe qeverisë qendrore, sigurimin e lidhjeve më të mira ndërmjet veriut dhe pjesës tjetër të vendit dhe krijimin e mekanizmave për serbët për pjesëmarrje më të madhe në jetën shoqërore të Kosovës. Po aq e rëndësishme, zbatimi i marrëveshjes për Asociacionin është obligim i mbetur, ligjërish i detyrueshëm, ndërkombëtar, për të cilën kërkohet veprim nga Kosova, Serbia dhe BE-ja dhe zotim ekzistues të Shteteve të Bashkuara në mbështetje të dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Zotimi i Kosovës për ta krijuar Asociacionin nuk e cenon Kushtetutën e saj, as nuk kërcënon sovranitetin, pavarësinë ose institucionet demokratike të saj. Ne e kundërshtojmë rreptësisht krijimin e çfarëdo etniteti që i përngjan Republikës serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë (BH); Bashkësia ndërkombëtare nuk po kërkon të imponojë një zgjidhje. Në vend të kësaj, ne po kërkojmë nga Kosova që ta ofrojë vizionin e saj për këtë Asociacion dhe jemi të gatshëm të ofrojmë ekspertizë dhe mbështetje politike për të siguruar që ajo funksionon në interesin më të mirë të kosovarëve. Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së ka vënë në pah se ekzistojnë 14 aranzhime të ngjashme brenda Bashkimit Evropian – asnjëri nga to nuk cenon sistemet evropiane të qeverisjes efektive. Brenda kornizës së dialo-

gut të lehtësuar nga BE-ja, Kosova mund të refuzojë opsionet që kërcënojnë strukturën e saj ligjore, por nuk mund të refuzojë zotimet e saj. Si vendi më prokosovar në botë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përkushtuara të mbështesin popullin e Kosovës për të siguruar që struktura e saj kushtetuese dhe ligjore nuk cenohet.

Si do të dukej Asociacioni? Komunat me interesa, gjuhë dhe kulturë të përbashkët do të mund të punonin në mënyrë më efektive bashku për t'i adresuar sfidat e përbashkëta në ofrimin e shërbimeve publike, nëpërmjet ekonomive të shkallës dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Për shembull, komunat do të mund të hartojnë kurrikulë në gjuhën serbe për shkollat lokale në disa komuna e të mos veprojnë në vakum dhe duke bërë punë të dyfishtë. Bashkëpunimi i tillë është në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2015 për zotimin për Asociacion dhe parimet e qeverisjes së mirë të ushtruara nëpër vendet e tjera në Evropë.

Çka nuk do të ishte Asociacioni? Nuk do t'ia shtonte Qeverisë së Kosovës një shtresë të re të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Ky parim i rëndësishëm daton që nga propozimi i Ahtisaarit. Komunat bashkëpunojnë në bashkëmenaxhimin e juridiksioneve brenda institucioneve dhe strukturave legjitime kosovare. Duke lejuar komunat e caktuara që në mënyrë më efektive të ushtrorjnë kompetencat që tashmë i kanë, kjo do të mënjanonte nevojën që qytetarët kosovarë të kërkojnë shërbime nga strukturat paralele ilegale – siç bëjnë shumë veta tani – dhe do të ruante transparencën dhe ligjshmërinë e strukturës së re sipas dhe brenda ligjit kosovar. Dhe çdo

mbështetje dhe ndihmë që Serbia do t'ia ofronte komunitetit serb të Kosovës do të duhej të ishte transparente dhe të shkonte përmes këtyre kanaleve legjitime dhe të lejuara.

Po ashtu, është me rëndësi të vihet në pah se një Asociacion i komunave me shumicë serbe nuk do të ishte njëetnik. Këto do të ishin komuna me shumicë serbe ku jetojnë jo vetëm serbët etnikë, por edhe grupet e tjera – shqiptarë, boshnjakë dhe të tjerë – të drejtat e të cilëve gjithashtu duhet të sigurohen dhe mbrohen. Anëtarët e Asociacionit do të ishin zyrtarë lokalë tashmë të zgjedhur si përfaqësues të të gjithë banorëve në komunat e tyre. Ndër shqetësimet kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ishte çështja se si të sigurohej që Asociacioni mbetet i hapur për të gjitha etnitë dhe të ishte plotësisht brenda strukturës së kornizës ligjore të Kosovës dhe ajo bëri thirrje që propozimi fillestar të përshtatej e të mos hidhej poshtë, si dhe theksoi obligimin për krijimin e një asociacioni të tillë sipas marrëveshjes së Brukselit.

Si mikja dhe aleatja më e afërt e Kosovës, ne besojmë se duke punuar për themelimin e Asociacionit, Kosova do të përmbushë një element kritik të nevojshëm për ndërtimin e të ardhmes së saj të drejtë si shtet sovran, shumëetnik dhe i pavarur, i integruar në strukturat euroatlantike. Jemi të gatshëm që ta mbështesim Kosovën për ta përmbushur këtë zotim dhe do të qëndrojmë krahu vendit tuaj në çdo hap. E ardhmja e Kosovës dhe Serbisë – dhe e të rinjve të saj që tash po shikojnë kah vendet e jashtme për mundësi – mund të jetë e ndritur në një Evropë „të tërë, të lirë dhe në paqe”. Krejt çka duhet është që ta shfrytëzojmë këtë moment së bashku.



# IFIMES: A mund të përjetojë Kosova të njëjtin fat si Afganistani dhe Iraku?



**N**ë dritën e tensioneve të fundit që rrezikojnë të eskalojnë në një konflikt të ri, IFIMES bëri një analizë të situatës aktuale në Kosovë. Ne sjellim pjesët më të rëndësishme dhe më interesante të analizës së gjerë të titulluar “Kosova 2023: Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit dhe Uashingtonit – Rruga drejt paqes së qëndrueshme dhe stabilitetit afatgjatë”.

Zhvillimet e fundit në veri të Kosovës të kujtojnë ngjarjet e viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar dhe kërcënojnë të eskalojnë në konflikt. Gjatë disa viteve të fundit ka pasur një mungesë të dukshme të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Beogradit zyrtar dhe Prishtinës. Përgjegjësia nuk qëndron vetëm tek pjesëmarrësit në dialog, por edhe tek BE-ja dhe gjithë bashkësia ndërkombëtare, e cila është dëshmuar të jetë inerte dhe jo efektive në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Miliarda euro/dollarët e parave të taksapaguesve të BE-së dhe SHBA-së që u shpenzuan kanë dhënë rezultate modeste.

Situata e krijuar në Kosovë ka historinë e saj. Republika e Serbisë ka lëshuar targa edhe për banorët e komunave në territorin e Kosovës dhe ato janë të vlefshme deri më 14 shtator 2021. Autoritetet e Kosovës në mënyrë të njëanshme kanë futur targa provuese për automjetet nga Serbia duke u thirrur

në parimin e “reciprocitetit” në lidhje me heqjen e targave. , sepse autoritetet e Kosovës kanë synuar të heqin targa me shenja të komunave serbe. Nën ndërmjetësimin e BE-së u ra dakord për një afat njëvjeçar për zgjidhjen e problemit, pavarësisht marrëveshjes fillestare për lirinë e lëvizjes, të cilën Beogradi dhe Prishtina e kishin ndërmjetësuar në Bruksel. Situata vazhdoi të përshkallëzohej pasi serbët e Kosovës nuk u lejuan të votojnë në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Serbi.

Kur skadoi marrëveshja e përkohshme e ndërmjetësuar me ndërmjetësimin e BE-së për targa, autoritetet e Kosovës filluan të njoftojnë se do të sanksionojnë shoferët që drejtojnë automjete me targa serbe dhe do t’i konfiskojnë automjetet e tilla. Kjo shkaktoi rezistencë të fortë në mesin e serbëve, veçanërisht në veri të Kosovës. Përfaqësuesit serbë janë tërhequr nga institucionet e Kosovës dhe kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës kanë dorëzuar dorëheqjen. Policët serbë u tërhoqën nga forca policore e Kosovës. Autoritetet e Kosovës u përpoqën të organizojnë zgjedhje urgjente lokale në katër komuna në veri me popullatë kryesisht serbe për të zgjedhur kryetarët e rinj dhe për të plotësuar pozitat e lira të kryetarëve të komunave, gjë që hasi në mosmiratim nga popullata dhe çoi në ngritje të pakënaqësisë me aktivitetet e tilla.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës (KQZ) u përpoq me ndihmën e forcave speciale të policisë së Kosovës të organizonte përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në veri të Kosovës, por u pengua fizikisht nga kjo. KQZ-ja vazhdoi veprimtarinë e saj në veri të Kosovës, e cila shkaktoi revoltë të fortë të popullatës serbe lokale dhe evoluoi në kryengritje të përgjithshme. Zgjedhjet urgjente lokale për këtë arsye u shtynë deri më 23 prill 2023 dhe partitë serbe do t'i bojkotojnë sërish nëse nuk krijohet ambient për mbajtjen e zgjedhjeve, pra nëse nuk arrihet marrëveshje politike. Ngritja e barrikadave pa soi si kundërpërgjigje ndaj arrestimit të tre serbëve, dhe veçanërisht të pjesëtarit deri vonë të forcës policore të Kosovës, Dejan Pantiq. Rreth pesëmbëdhjetë barrikada u ngritën në vende të ndryshme. Autoritetet e Prishtinës kërcënuan se policia do t'i largojë me forcë barrikatadat, por më pas kërkuan nga KFOR-i që t'i largojë barrikatadat.

### **A mund të përjetojë Kosova të njëjtin fat si Afganistani dhe Iraku?**

Serbia është e rrethuar me vende anëtare të NATO-s dhe është e vetëdijshme për pozicionin e saj. Duke u mbështetur në përvojën e saj historike, ajo nuk dëshiron të jetë e para që fillon ndonjë konflikt të ri dhe të mbajë barrën dhe përgjegjësinë për fillimin e një konflikti. Për sa i përket historisë së saj moderne, zhvillimi ekonomik i Serbisë është në zenitin e tij historik me investime të huaja rekord në vitin 2022 që arrijnë në më shumë se katër miliardë euro. Një pjesë e opozitës serbe dhe partive politike shqiptare përmes Listës Srpske (SL) /Lista Serbe/ rregullisht tentojnë të lajnë hesapet me presidentin serb Aleksandar Vuçiq (SNS). Një konflikt i ri i mundshëm për Kosovën nuk do të kishte karakter lokal dhe do të përhapej me shpejtësi. Pyetja që shtrohet është nëse elitat politike të Kosovës janë të gatshme ta shtyjnë të ardhmen e Kosovës për hir të politikave të tyre të papërgjegjshme.

Analistët besojnë se Serbia nuk dëshiron të përsërisë gabimet e së kaluarës. Një konflikt mund të fillojë nga disa palë të tjera, jo vetëm Serbia dhe Kosova, pra serbët dhe shqiptarët. Lufta në Ukrainë ka treguar se ekzistojnë qendra kundërshtare policentrike të pushtetit, të cilat kanë interes për përshkallëzimin e konflikteve në pjesë

të ndryshme të Evropës. Lufta e Ukrainës nuk duhet të “kopjohet” në Ballkan, i cili ende nuk i ka shëruar plagët nga luftërat e mëparshme. Lëvizjet e njëanshme mund të çojnë në përshkallëzim.

Një pikë shqetësuese është informacioni se një pjesë e establimentit në Uashington po shqyrton opsionin e tërheqjes së trupave amerikane nga Kosova, siç është bërë në Afganistan dhe Irak. Një skenar i tillë nuk do të ishte i mirë as për Kosovën dhe as për Evropën Juglindore, sepse prania e SHBA-së është garantues i paqes dhe stabilitetit relativ në atë pjesë të Evropës. Kosova dhe qytetarët e saj kanë të drejtë për të ardhmen e tyre dhe strukturat politike nuk duhet të lajnë me të. Situata në Kosovë ilustron më së miri përmes faktit se Kosova ende ka një regjim vizash me vendet anëtare të BE-së, madje edhe me Bosnjën dhe Hercegovinën. Kjo është pamja reale e Kosovës sot. Më e rëndësishmja në këtë moment është se serbët në barrikatadat e ngritura i janë përgjigjur apelit të presidentit serb Aleksandar Vuçiq për heqjen e barrikadave dhe organet e drejtësisë së Kosovës kanë liruar nga paraburgimi Dejan Pantiqin, arrestimi i të cilit ka qenë shkak për ngritjen e barrikadave. Përfundimisht, arritja e ndonjë progresi do të kërkonte përfundimin e gjenerimit të rregullt të krizave në Kosovë.

### **Shtyrja e konfliktit**

Themelimi i Bashkësisë së Komunave Serbe (ZSO) është kusht i vendosur nga Lista Serbe (SL) për kthimin e serbëve në institucionet e Kosovës, kusht për heqjen e barrikadave është tërheqja e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës nga veriu dhe lirimi nga tre serbët që ishin arrestuar. Autoritetet e Kosovës i dhanë garanci BE-së dhe SHBA-së se nuk do të ketë arrestime të serbëve për pjesëmarrje në protesta dhe ngritjen e barrikadave, të cilat hapën rrugën për heqjen e barrikadave. Ndërkohë që barrikatadat janë hequr, tensionet dhe mosbesimet kanë mbetur.

Analistët mendojnë se incidentet në Kosovë duhet të kuptohen jashtëzakonisht seriozisht dhe se duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme që ato të mos përsëriten, sepse situata aktuale në rajon dhe Evropë, në kontekstin e krizës në Ukrainë, është reale. Sfidat dhe kërcënimi i sigurisë. Një metodë e tillë e zgjidhjes së krizave të krijuara vetëm e shtyn një konflikt, i cili po bëhet gjithnjë e më i sigurt.



# 30 vjetori i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike/ Shqipëria do të hapë ambasadë në Ukrainë

**S**hqipëria do të ketë së shpejti ambasadën e saj në Kiev, në kryeqytetin e Ukrainës.

Kështu njoftoi ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë, Olta Xhaçka, në kohën kur po shënohet 30 vjetori i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve.

“Shqipëria do të mbështesë Ukrainën dhe popullin e saj me maksimumin e aftësive të saj derisa të triumfojë kundër luftës së paligjshme të agresionit të Rusisë. Shqipëria dhe Ukraina i përkasin familjes së kombeve të lira dhe demokratike dhe të dyja kanë një të ardhme në familjen Euro-Atlantike”, shkroi Xhaçka në një postim në Facebook.

Që prej 24 shkurtit të vitit 2022 kur nisi pushtimi rus i ukrainës, Shqipëria, anëtare e NATO-s që nga viti 2009, është rreshtuar me këtë aleancë ushtarake dhe me Bashkimin Evropian në mbështetje të Ukrainës.

Në kuadër të kësaj mbështetje janë miratuar disa vendime, që lejojnë shtetasit e Ukrainës të hyjnë dhe qëndrojnë pa leje të qëndrimit në Shqipëri për një periudhë 1 vjeçare si dhe krijimin e një task-force për të menaxhuar aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare për shtetasit që vijnë nga Ukraina.

Autoritetet shqiptare gjithashtu kanë përkrahur rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që dënon pushtimin rus të Ukrainës dhe, së voni, kanë ndërmarrë një iniciativë për dokumentimin dhe hetimin e krimeve të luftës në Ukrainë, përmes OKB-së.

Para fillimit të luftës dhe sanksioneve që u vendosën ndaj Rusisë, sipas të dhënave të Instituti të Statistikave (INSTAT), Shqipëria ka importuar mbi 40 për qind të totalit të drithërave nga Ru-



sia, ndërsa 4 për qind nga Ukraina.

Sipas ambasadës ukrainase në Tiranë, që nga shkurti i vitit 2022, në Shqipëri janë strehuar afërsisht 3 mijë shtetas ukrainas.

Më 3 maj të vitit që shkoi, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky iu drejtua me një fjalim online Kuvendit të Shqipërisë. Përveç falenderimit për mbështetjen, ai kërkoi që t'u ndalohej hyrja në Shqipëri, turistëve rusë.

Kjo kërkesë nuk u mor parasysh nga qeveria shqiptare.

Marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve janë vendosur më 13 janar 1993, ndërsa Ukraina ka hapur ambasadën e saj në Tiranë në shtator të vitit 2020.

Ambasador i saj është emëruar Volodimir Shkurov, i cili është ende në detyrë.

Në Ukrainë, në rajonin e Odesës jetojnë rreth 3500 shqiptarë.

# Kina dhe Shqipëria në një marrëveshje monumentale për heqjen e vizave



Dr. MARSELA MUSABELLIU

**M**ë 16 janar 2023 u firmos zyrtarisht “Marrëveshja për heqjen reciproke të vizave” ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë. Kjo marrëveshje përcakton se shtetasit e të dy vendeve nuk do të kenë nevojë për vizë nëse qëndrojnë në vendin tjetër deri në 3 muaj. Marrëveshja hyn në fuqi pasi palët të kenë përfunduar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme, dhe sipas kryeministrit shqiptar pas 30 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, kjo lehtësi për qytetarët e të dy vendeve do të jetë e aplikueshme në praktikë. Republika Popullore e Kinës dhe Shqipëria janë dy vende që kanë një histori të gjatë bashkëpunimi, e cila me kohën është transformuar në miqësi tradicionale. Midis dy shteteve duket se ekziston dëshira për të çuar përpara marrëdhëniet mbi bazat e mirëkuptimit të ndërsjellë. Në këtë aspekt lehtësimi i kalimit ndërkufitar bëhet një hap i jashtëzakonshëm për të thelluar dhe zgjeruar këto marrëdhënie të cilat mbartin shenja optimizmi dhe entuziazmi për potencialin që mund të kenë shkëmbimet dypalëshe në epokën e re.

Angazhimi i Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri ka qenë tejet intensiv në realizimin e kësaj marrëveshjeje. Në fakt, po të shohim takimet e ambasadorit z. Zhou Ding, me instancat më të larta të vendimarrjes politike të Shqipërisë, vihet re vendosmëria dhe qasja e tij proaktive në arritjen e rezultateve konkrete në marrëdhëniet dypalëshe. Në çdo shfaqje publike dhe takime, ambasadori Zhou ka shprehur se vendi i tij është i gatshëm të nxisë në mënyrë efektive shkëmbimet dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve në fushat e ekonomisë, tregtisë, turizmit, kulturës e arsimit dhe do të thellojë më tej miqësinë ndërmjet dy popujve. Në fakt kjo marrëveshje, është si shënon z.Zhou një “dhuratë e madhe” për popullin shqiptar në fillim të vitit të ri 2023.

Si u arrit deri këtu?

Autoritetet kineze kanë qenë përherë të gatshme të zgjasin dorën e bashkëpunimit me Shqipërinë, dhe kjo marrëveshje është një rezultat i vitesh pune dhe komunikimi mes palëve. Ky është një zhvillim i rëndësishëm në marrëdhëniet kino-shqiptare si dhe një tjetër ilustrim i miqësisë mes dy vendeve. Gjatë vitit 2022, ekipet kineze dhe shqiptare kanë punuar së bashku për ta realizuar nënshkrimin e saj.

Angazhimi i Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri ka qenë tejet intensiv në realizimin e kësaj marrëveshjeje. Në fak, po të shohim takimet e ambasadorit z. Zhou Ding, me instancat më të larta të vendimmarrjes politike të Shqipërisë, vihet re vendosmëria dhe qasja e tij proaktive në arritjen e rezultateve konkrete në marrëdhëniet dypalëshe. Në çdo shfaqje publike dhe takime, ambasadori Zhou ka shprehur se vendi i tij është i gatshëm të nxisë në mënyrë efektive shkëmbimet dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve në fushat e ekonomisë, tregtisë, turizmit, kulturës e arsimit dhe do të thellojë më tej miqësinë ndërmjet dy popujve. Në fakt kjo marrëveshje, është si shënon z.Zhou një “dhuratë e madhe” për popullin shqiptar në fillim të vitit të ri 2023.

Po të kthehemi pak në kohë, në fund të vitit 2021, Këshilltari i atëhershëm i Shtetit dhe Ministri i Jashtëm i Kinës, Wang Yi, pati një vizitë të suksesshme në Shqipëri ku nënvizoi sërish gatishmërinë e qeverisë kineze për thellim bashkëpunimi të dobishëm në fusha të ndryshme.



*Forumet e shumta në kuadër të nismës “Një brez, një rrugë” kanë vënë theksin mbi faktin se formalitetet e udhëtimit (që përfshijnë imponimin, përpunimin dhe menaxhimin e vizave, formalitetet kufitare dhe rregulloret doganore) përbëjnë pengesa të theksuara logjistike. Për këtë aspekt në Kinë janë ngritur dhjetëra grupe pune në mënyrë që të arrihen lehtësime për bashkëpunim, dhe një nga këto lehtësime është heqja e vizave.*

Nismat kineze si “Motor i dyfishtë”: Shqipëria është pjesë e dy nismave kineze, njëra globale “Një brez, një rrugë” dhe tjetra rajonale Kinë-Evropë Qendrore dhe Lindore (Kinë-EQL). Këto platforma tejet aktive të multilateralizmit kanë hapur terrene të reja bashkëpunimi midis vendeve anëtare. Kina ka suportuar gjerësisht efektin shtytës të këtyre nismave në mënyrë që të shërbejnë për të ndihmuar vendet e rajonit tonë të arrijnë në përfitime të shumta. Nga pala kineze këto dy nisma janë quajtur “Motor i dyfishtë” dhe rruga më efikase për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe për të përkthyer potencialin e bashkëpunimit në rezultate të prekshme.

Platforma Kinë-EQL, që prej vitit 2012 ka qenë një mekanizëm rajonal tejet aktiv në komunikimin politik. Samitet e nivelit të lartë Kinë-EQL kanë dëshmuar një ndërveprim të intensifikuar nga të dyja palët me zhvillime premtuese vit pas viti për marrëdhëniet

Kinë-Shqipëri. Në vitin 2017, në Samitin e Sofies në kuadër të nismës Kinë-EQL, kryeministri kinez Li Keqiang i shprehu kryeministrit Edi Rama se Kina është e vendosur të punojë me Shqipërinë për të përsheptuar përafrimin e strategjive të tyre të zhvillimit dhe për të ngritur lidhjet dypalëshe në një nivel të ri. Në vitin 2018, qeveria shqiptare zbatoi politikën e heqjes së vizave për shtetasit kinezë gjatë sezonit turistik (6 muaj) dhe në fund të vitit 2019, ajo filloi heqjen e vizave gjatë gjithë vitit për shtetasit kinezë. Vetëm heqja e vizave për 6 muaj, bëri që turistët kinezë në Shqipëri të rriten gjatë vitit 2018 me +48%.

Lehtësimi i vizave është pjesë e strategjisë së zhvillimit të turizmit të Rrugës së Mëndafshit, ose nismës “Një brez, një rrugë”. Që prej shpalljes së saj në vitin 2013, Kina promovon bashkëpunimin doganor, ndërkuftar dhe ndërkombëtar midis vendeve të nismës për lehtësirat e kontrollit kufitar dhe lehtësimin



e vizave. Forumet e shumta në kuadër të nismës “Një brez, një rrugë” kanë vënë theksin mbi faktin se formalitetet e udhëtimit (që përfshijnë imponimin, përpunimin dhe menaxhimin e vizave, formalitetet kufitare dhe rregulloret doganore) përbëjnë pengesa të theksuara logjistike. Për këtë aspekt në Kinë janë ngritur dhjetëra grupe pune në mënyrë që të arrihen lehtësime për bashkëpunim, dhe një nga këto lehtësime është heqja e vizave.

### **Bashkëpunim me përfitim të ndërsjellë, nga teoria në praktikë**

Çfarë do të mundësojë dhe çfarë do të nxisë më tej kjo marrëveshje? Lehtësimi i vizave është thelbësor për stimulimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës përmes turizmit dhe industrive vartëse të tij. Studimet empirike në rang botëror kanë vërtetuar se marrëveshjet për lehtësimin e vizave nxisin kontaktet mes njerëzve. Ka shumë përfitime për Shqipërinë në këtë aspekt, por le të analizojmë ato me më tepër impakt:

**TURIZMI:** Sektori i turizmit në Shqipëri ka një kontribut të drejtpërdrejtë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) 8-12% në varësi të vitit, dhe ka një kontribut dytësor ose siç quhet ndryshe indirekt (me anë të tregtarëve dhe industrive ekstra që i shërbejnë turizmit) që arrin deri në 25%. Pra, rëndësia e këtij sektori është tejet e lartë për ekonominë totale të Shqipërisë. Para shpërthimit të pandemisë udhëtarët kinezë nëpër botë arritën shifrën rekord prej 155 milion. Kontributi i udhëtarëve kinezë në turizmin global ishte

**Sektori i turizmit në Shqipëri ka një kontribut të drejtpërdrejtë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) 8-12% në varësi të vitit, dhe ka një kontribut dytësor ose siç quhet ndryshe indirekt (me anë të tregtarëve dhe industrive ekstra që i shërbejnë turizmit) që arrin deri në 25%. Pra, rëndësia e këtij sektori është tejet e lartë për ekonominë totale të Shqipërisë.**

më i larti dhe është llogaritur që kanë shpenzuar rreth 245 miliardë dollarë në total (në vitin 2019). Me lehtësimin e masave anti-epidemike në vitin 2023, pritet që trendi i turistëve kinezë në botë të rikthehet dhe ndoshta të rritet. Me anë të lehtësimit të vizave, këtyre udhëtarëve ju lehtësohet Shqipëria si destinacion dhe sektori i turizmit do të ketë padyshim përfitime të mëdha.

**TREGTIA:** Sipas studimeve të OKB-së është vërtetuar se vendet të cilat nuk kanë barriera vizash midis tyre, kanë më tepër intensifikim marrëdhëniesh tregtare, sidomos me bizneset e vogla dhe të mesme. Për sa i përket Shqipërisë, tregtia është një aspekt kryesor i ekonomisë kombëtare dhe është shumë e varur nga importet. Importet nga Kina në shqipëri, në varësi të vitit zënë vendin e tretë ose të katërt (pas Italisë e Turqisë) dhe ajo është shumë e rëndësishme

pasi kategoritë e produkteve nga Kina në tregun shqiptar vetëm janë rritur. Tregtarët shqiptarë e kanë njohur tregun kinez shumë herët, dhe tashmë me heqjen e vizave drejt Kinës rruga e tyre e biznesit bëhet më e lehtë.

**SHKËMBIMET NJERËZORE:** Sistemi i vizave dhe heqja e tyre, kthehen nga një pengesë në një mundësi, dhe situatat e reja që krijohen bëhen thelbësore për të vazhduar angazhimin kuptimplotë në dialogun midis kombeve dhe kulturave. Një nga bazat e qasjes së politikës së jashtme kineze është ndërlidhja dhe shkëmbime të intensifikuara mes njerëzve. Përmes njohjes më të mirë midis njerëzve përmirësohen lidhjet kulturore dhe kuptohen më mirë realitetet e njëri-tjetrit duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e përbashkët. Dhe, siç thotë një thënie e lashtë kineze “miqësia midis njerëzve mban çelësin e marrëdhëniesh të shëndosha midis shteteve”.

*Së fundmi*, nëse ka një vend në Evropë që ka përjetuar në vetë të parë atë që Kina është në gjendje të arrijë dhe të bëjë në një tokë të largët dhe të huaj, ky vend është Shqipëria, pasi shqiptarët e kanë parë për shumë kohë marrëdhëniesh intensive në vitet 1960-70 çdo të thotë “bashkëpunim me karakteristika kineze”.

Që prej Kongresit të 20-të të PKK-së, Kina ka hyrë në një epokë të re, dhe në këtë epokë duket se qytetarët shqiptarë do të jenë të privilegjuar, duke ju hapur tregu gjigand i ekonomisë së dytë në botë dhe dyert e një vendi prej 1.4 miliard njerëzish që shqiptarët i konsiderojnë miq!

# Ish-zyrtari i arrestuar i FBI-së dhe lidhjet me Shqipërinë

**T**ë mërkurën, ish zyrtari i lartë i kundërzbulimit të FBI-së, Charles McGonigal, arrestuar të shtunën nga autoritetet amerikane, pritet të dalë para gjykatës në Uashington për t'u shprehur nëse i pranon apo jo akuzat se ka marrë para nga një ish-punonjës i shërbimeve inteligjente shqiptare dhe për lidhjet e tij me zyrtarë të tjerë në Shqipëri.

Të hënën, ai nuk i pranoi akuzat e tjera të ngritura ndaj tij në Nju Jork, se ka shkelur sanksionet amerikane ndaj Rusisë duke punuar për oligarkun rus Oleg Deripaska. Gjykata vendosi që ta lërë të lirë kundrejt pagesës, gjatë kohës që do të zhvillohet procesi gjyqësor.

Charles McGonigal ka punuar për sektorin e kundërzbulimit të FBI-së, derisa u largua nga FBI-ja në shtator të vitit 2018 dhe ndër të tjera mbulonte edhe Shqipërinë dhe Bosnje Hercegovinën.

Ai akuzohet se ka marrë 225 mijë dollarë nga një ish-punonjës i shërbimeve sekrete të Shqipërisë dhe ka zhvilluar një sërë takimesh me biznesmenë dhe politikanë në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnje, por pa i raportuar ato sipas rregullave.

Sipas aktapadisë, lidhjet e tij kryesore me Shqipërinë janë mbajtur përmes ish zyrtarit shqiptar të shërbimeve sekrete, që në akt-akuzë identifikohet si Personi A. Ky person ka paguar edhe për shpenzimet e tij të udhëtimit në Shqipëri.



Akt-padia e bërë publike dje nga gjykata në Uashington nuk e identifikon më tej Personin A. Por, në bazë të një njoftimi tjetër të shtypit amerikan, në shtator të vitit të kaluar, ku njoftohej se ish zyrtari i FBI-së McGonigal ishte nën hetime, portali “Business Insider” boton kopjen e një dokumenti të jurisë së madhe, ku në listën e atyre, që do të thirreshin për të dëshmuar, figuron shtetasi Agron Neza, shqiptaro-amerikan, që dekada të shkuara ka punuar për shërbimet inteligjente të Shqipërisë.

Personi i dytë nga Shqipëria, i lidhur me ish zyrtarin e FBI-së, identifikohet në akt-padi si Personi B, i cili “ishte një shtetas shqiptar, i punësuar nga një konglomerat kinez energjie. Personi

B shërbente si një këshilltar jozyrtar i Kryeministrit të Shqipërisë, i cili kishte një llogari emaili dhe pasaportë zyrtare të qeverisë shqiptare dhe ka qënë ish-zyrtar i lartë i qeverisë shqiptare.”

Nëse i referohemi sërish dokumentit të jurisë së madhe, në të, personi tjetër, që duhej marrë në pyetje është Dorian Duçka, ish zv/ministër për energjitikën dhe më pas konsulent i pavarur.

Personi A dhe Personi B, sipas akt-padisë, “ishin miq dhe partnerë biznesi me njëri-tjetrin.”

Sipas dokumentit të akuzës, gjatë një udhëtimit në Shqipëri në vitin 2017, “më 9 shtator i pandehuri McGonigal u takua me kryeministrin shqiptar [Edi Rama] dhe me Personin B [Dorian Duçka].

Me kërkesë të Personit A [Agron Neza] ai i bëri thirrje kryeministrit të kishte kujdes dhe të mos i jepte liçenca për kërkime nafte në Shqipëri një kompanie ruse guackë. Personat A dhe B kishin interesa financiarë nga vendimi i qeverisë shqiptare. I pandehuri McGonigal i dha kryeministrit një suvenir të FBI-së në prani të personit B”.

Akt-padia vendos një lidhje të drejtpërdrejtë të takimeve të ish zyrtarit të FBI-së me kryeministrin shqiptar në prani të personave të tretë A dhe B, që ishin shtetas privatë. Është e paqartë se përse kryeministri është takuar me një zyrtar të lartë të FBI-së në prani të personave privatë.

I pyetur nga Zëri i Amerikës, lidhur me marrëdhëniet e kryeministrit me ish zyrtarin e FBI-së, zëdhënësi i qeverisë mohoi, që takimet të kenë patur ndonjë lidhje me ato që thuhet në akt-padi: “Siç e ka sqaruar edhe më parë, kryeministri Edi Rama ka pasur një raport miqësor me zyrtarin e FBI, me të cilin janë takuar disa herë, qoftë në Tiranë, qoftë në New York, po takimet e tyre s’kanë pasur asnjë lidhje me çka thuhet në akt-padinë në fjalë lidhur me persona të tjerë.”

Sipas akt-padisë, ishte pas këtij udhëtimi në Shqipëri në shtator që “i pandehuri McGonigal ka mbajtur një miqësi të vazhdueshme me Kryeministrin [Rama].”

Sipas akt-akuzës, nga shtatori 2017 deri në mars 2018, McGonigal dhe Kryeministri Rama janë takuar 4 herë në Shqipëri dhe në SHBA.

Sipas akt-padisë, gjatë vizitës së shtatorit 2017, McGonigal “u prezantua nga personi A me një biznesmen dhe politikan shqip-

“

**Akt-padia vendos një lidhje të drejtpërdrejtë të takimeve të ish zyrtarit të FBI-së me kryeministrin shqiptar në prani të personave të tretë A dhe B, që ishin shtetas privatë. Është e paqartë se përse kryeministri është takuar me një zyrtar të lartë të FBI-së në prani të personave privatë.**

”

”

tar, i cili i kërkoi atij ndihmë, që dikush të hetonte për një komplot të dyshuar për të vvarë biznesmenin dhe politikanin”.

Disa javë pas këtyre takimeve, më 5 tetor 2017, sipas akt-padisë, “jashtë një restoranti, në një makinë të parkuar në Nju Jork, McGonigal mori afro 80 mijë dollarë kesh nga Personi A. Po atë vjeshtë ai mori edhe dy pagesa të tjera nga Personi A në shumat 80 mijë dollarë dhe 65 mijë dollarë në rezidencën e banorit A. McGonigal i la të kuptohej Personit A se paratë do t’ia kthente.”

Sipas akt-akuzës, McGonigal i kishte kërkuar Personit A nëse ai mund t’i siguronte një sasi parash që në gusht të vitit 2017 dhe një muaj më pas në shtator, ata kishin diskutuar përsëri rreth përpjekjeve të Personit A që t’ia siguronte paratë dhe që Personi A t’ia jepte ato pjesë-pjesë.

Dy muaj pas vizitës në Shqipëri, më 18 nëntor 2017 McGonigal së bashku me një prokuror nga Departamenti i Drejtësisë, takuan dhe morën në intervistë në Austri, biznesmenin-politikan, që ai e kishte takuar në shtator në Shqipëri. Personi A mori pjesë në këtë takim si përkthyes.

Intervista e biznesmenit-politikan nuk është raportuar dhe nuk figuron në dokumentet e FBI-së. Në të njëjtën ditë të intervistimit në Austri, po më 18 nëntor, McGonigal dhe biznesmeni-politikan, janë takuar edhe në Shqipëri, por këtë herë pa praninë e prokurorit të Departamentit të Drejtësisë. Sipas akt-padisë “politikani-biznesmen diskutoi me të pandehurin McGonigal dhe Personin A për mundësi biznesi”.

“Më 19 nëntor i pandehuri takohet me Personin B për darkë dhe një ditë më pas më 20 nëntor takohet me kryeministrin”, sipas akt-padisë.

Menjëherë pas kthimit nga Shqipëria, më 25 nëntor, McGonigal informon Prokurorin e Departamentit të Drejtësisë, me të cilin takoi politikanin-biznesmen në Austri, për një hetim të mundshëm kriminal për një shtetas amerikan, që ishte regjistruar për të bërë lobizëm “për një parti që nuk ishte e kryeministrit Rama”. Sipas akt-padisë, një ditë më herët McGonigal kishte marrë informacion për këtë lobist nga Personi B.

Në akt-padi nuk identifikohet lobuesi amerikan dhe as partia shqiptare. Por më 14 nëntor të vitit 2017, lobisti Nick Muzin, depozitoi në Departamentin e Drejtësisë, ndonëse me vonesë, dokumentet mbi aktivitetin lobues të disa muajve më parë për llogari



të PD-së, i cili më pas është bërë subjekt hetimi në Shqipëri për origjinën e parave.

Në akt-padinë ndaj McGonigal, përmendet se në dhjetor të vitit 2017 ai është takuar në Uashington me personin A dhe zyrtarë të qeverisë shqiptare dhe në Nju Jork me Personin A dhe kryeminstri Rama.

Më 4 janar 2018, sipas akt-akuzës, McGonigal mori informacion për lobistin amerikan nga Personi A dhe të nesërmen ia dërgoi informacionin një agjenti tjetër të zyrës së FBI-së në Nju Jork.

Më 22 janar ai mori përsëri informacion nga Personi A për lobistin dhe ia dërgoi një vartësi. Personi A, sipas akuzës e kishte marrë informacionin nga zyra e Kryeministrit të Shqipërisë.

Sipas akt-padisë “më 26 shkurt 2018, zyra e FBI-së në Nju Jork hap zyrtarisht hetime të përqendruar tek lobisti amerikan me kërkesën dhe nën udhëzimin e zotit McGonigal. Më pas Personi A u identifikua si burim konfidencial në mbështetje të hetimit. Personi A i ka ofruar informacione zyrës së FBI-së në Nju Jork gjatë hetimit.”

Po sipas akt-padisë “Më pas Personi B ndihmoi në organizimin e një takimi mes zyrës së FBI-së në Nju Jork dhe dëshmitarëve në Evropë, duke paguar mes të tjerash për shpenzime udhëtimi të dëshmitarëve”.

Më 25 qershor 2018, i pandehuri McGonigal, i ka propozuar personit A që të nënshkruajë një kontratë me një individ nga Bosnia të indentifikuar si Personi D në mënyrë që në kompaninë e personit A të depozitoheshin 500 mijë dollarë nga Personi D dhe

“Më 19 nëntor i pandehuri takohet me Personin B për darkë dhe një ditë më pas më 20 nëntor takohet me kryeminstriin”.

firma e tij farmaceutike për të mundësuar një takim mes Personit D dhe një përfaqësuesi të delegacionit amerikan në OKB.

Ndërkohë që në muajin prill, McGonigal ishte takuar në Gjermani me dy individë nga Bosnja, Personin C dhe Personin D, të cilët kishin lërkuar të takoheshin me ambasadorën amerikane në OKB-së, ose ndonjë zyrtar tjetër të lartë për një çështje politike për Bosnje Hercegovinën.

#### Akuzat për shkeljen e sanksioneve ndaj Rusisë

Akt-padia tjetër ndaj ish zyrtarit të lartë të FBI-së ka lidhje me ndihmën për oligarkun rus, Oleg Deripaska, në shkelje të sanksioneve amerikane. Aktiviteti i tij në favor të miliarderit rus është zhvilluar pasi ishte larguar nga FBI-ja. Ai akuzohet se ka bashkëpunuar me një ish diplomat rus, Sergey Shestakov, që tashmë punonte si përkthyes për miliarderin rus Oleg Deripaska.

